



Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i shkallës së parë në përbërje prej: Metë Çeku – kryetar, Avni Shala dhe Donat Lushaku – anëtarë, **duke u mbështetur në nenin 63 të Statutit të FFK-së, si dhe nenit 8, paragrafi 1, pika d), nenit 60, paragrafi 1, pika a), e) dhe f) nën 1, nenit 91, dhe 92, pika b) të Rregullores Disiplinore të FFK-së, nenit 51, paragrafi 1, nenit 52, paragrafi 2, pika e) dhe nenit 53 të Propozicioneve të Garave 2023/2024**, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.04.2024 në ora 14:00 shqyrtoi procedurën e inicuar disiplinore të Komisionit të Garave të datës 11.04.2024 ndaj Ridon Llugiqi, Lojtar i KF “Ulpiana 1926” për kurdisje të rezultatit në ndeshjen e rregullt të xhiros së XXI-të Raiffeisen Liga e Parë (Grupi B) të zhvilluar në mes të KF “Ulpiana 1926” nga Lipjani dhe KF “Vllaznia (P)” nga Pozherani-Viti, merrë këtë:

V E N D I M

Ridon Llugiqi - Lojtar i KF “Ulpiana” nga Lipjani me Nr.ID: 006950M04 dhe numër 12 të fanellës sportive, për marrëveshje në kurdisje të rezultatit **DËNOHET** me ndalesë loje në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, për të gjitha ndeshjet zyrtare vijuese të organizuara nga FFK.

A r s y e t i m

Më datë 07.04.2024 me fillim nga ora 15:00 është zhvilluar ndeshja kampionale (xhiro XXI) e Raiffeisen Liga e Parë (Grupi B) në mes të KF “Ulpiana 1926” Lipjan dhe KF “Vllaznia - Pozheran” nga Pozherani, Viti në Stadiumin “Sami Kelmendi” në Lipjan. Rezultati final u përfundua me shifrat 3:4 në favor të ekipit mysafir.

Me datë 11 prill 2024, Komisioni i Garave i Superligës dhe Ligës së Parë ka nxjerr Vendim, përmes të cilit ka anuluar sipas detyrës zyrtare ndeshjen Raiffeisen Liga e Parë e zhvilluar ndërmjet KF Ulpiana-KF Vllaznia Pozheran java 21 e përfunduar me rezultat 3:4 në favor të KF Vllaznia (P), dhe e njëjta është regjistruar si ndeshje e luajtur dhe rezultati i saj nuk regjistrohet, po ashtu pikët dhe golët e shënuara nuk do regjistrohen në tabelën e klasifikimit, për arsye se Komisioni. Përmes të njëjtit vendim konform dispozitave të akteve normative të FFK-së , është inicuar procedura disiplinore ndaj të gjithë personave të përfshirë në këtë ndeshje.

Me Vendimin e lartcekur, Komisioni i Garave i Superligës dhe Ligës së Parë ka inicuar procedurën disiplinore ndaj lojtarit Ridon Llugiqi sepse ekzistojnë xhirimet televizive, të cilat janë përdorur si prova materiale të cilat vërtetojnë mungesën e angazhimit të ekipit vendas, respektivisht të lojtarit (portierit) Ridon Llugiqi, i cili bart fanellën me numër 12, kësisoji duke shkelur dispozitën e nenit 60, paragrafi 1, pika e), e Rregullores Disiplinore e cila përkufizohet si *“lëshim i qëllimshëm i kundërshtarit të shënoj gol pa angazhim, angazhim inert, mos dëshirë për lojë, dëmtim i ekipitë tij me qëllim”*. Veprime të tilla, pra të mosangazhimit, në rastin konkret të lojtarit të lartcekur shihen në shënimin e golit të tretë dhe të katërt të ekipit mysafir.



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO

Komisioni pati në dispozicion prova të ofruara nga zyrtarët kompetent të FFK-së për ndeshjen për ndeshjen KF “Ulpiana 1926” dhe KF “Vllaznia (P)”, xhirimet televizive nga ndeshja e zhvilluar, të dhënat në raportet tjera konfidenciale, e që janë dëshmi valide se kemi të bëjmë me shkelje të Statutit dhe Rregulloreve të FFK-së.

Andaj konform të lartcekurave, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi për shqiptimin e masës disiplinore ndaj lojtarit të klubit të involvuar në marrëveshje për kurdisje të rezultatit të ndeshjes, si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Prishtinë, 19.04.2024

Komisioni Disiplinor dhe i Etikës – shkalla e parë

Kryetar: Metë Çeku

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese drejtuar Komisionit Disiplinor të shkallës së dytë - Komisionit të Apelit, në afatin kohor prej 8 (tetë) ditësh nga data e pranimit, publikimit të vendimit në faqen zyrtare të FFK-së. Ankesa e ushtruar nga ana e palës së ankimuar nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.